




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. B: Prot. 01-2089/2012
Nr. i t. Broj: stranica 02	Data Datum 13.06.2012
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4811/11, z.Gjelosh Gojani, Anëtar i Bordit të Drejtoreve ne "KUR-HIDRODRINI"- Pejë, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-4811/11,që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Gjelosh Gojani, Anëtar i Bordit të Drejtoreve "KUR-HIDRODRINI"- Pejë

Pas zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Anëtar i Bordit të Drejtoreve ne "KUR-HIDRODRINI"- Pejë, ka qenë i regjistruar ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve si pronarë dhe person i autorizuar ne biznesin N.SH. "AKK", dhe ne te njëjtën kohe ka ushtruar edhe funksionin e zyrtarit te lartë si, Anëtar i Bordit të Drejtoreve ne "KUR-HIDRODRINI"- Pejë, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 01.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Gjelosh Gojani, me datën 13.03.2012, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë ka ardhur te ballafaqohet me faktet qe posedon Agjencia, gjate takimit qe është

mbajtur ne zyrat e AKK-se është biseduar për gjendjen dhe faktet që disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit.

Zyrtari i Lart, z. Gjeloš Gojani, gjatë takimit është pajtuar për situatën mirëpo është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi që nuk e ka informuar askush që nga momenti i zgjedhjes si Anëtar i Bordit të Drejtoreve "KUR-HIDRODRINI", dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë që mundë të shkaktoj Konflikt të mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, pasi që ka menduar se biznesi që ka qenë regjistruar por nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet dhe është pasiv, mund të shkaktoj Konflikt të Interesit

z. Gjeloš Gojani, Anëtar i Bordit të Drejtoreve "KUR-HIDRODRINI"- Pejë, është zotuar se në afatin ligjor do të bëjë azhurnimin e të dhënave apo do të shuaj tereshit këtë biznes pasi që nuk zhvillon asnjë aktivitet, dhe do të bëjë shmangien Konfliktit të mundshëm të Interesit gjatë kohës sa ushtron funksionin Publik si Anëtar i Bordit të Drejtoreve "KUR-HIDRODRINI"- Pejë.

Me datën 11.05.2012, Zyrtari i Lartë z. Gjeloš Gojani, Anëtar i Bordit të Drejtoreve në "KUR-HIDRODRINI"- Pejë, ka sjellë dëshminë se ka bartur funksionet menaxhuese tek një person tjetër dhe nuk ka me asnjë funksion udhëheqës në atë biznes, më anë të dokumentit të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, dëshmohet se z. Gjeloš Gojani nuk është me në pozitën e personit të autorizuar dhe nuk ka funksione menaxhuese, konstatohet se z. Gjeloš Gojani ka shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

